



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, _____ 2018

Lënda: Njoftim për vende të lira pune

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK
Buletinit të shkollave të larta

Tiranë

Universiteti i Tiranës shpall konkursin **për 3(tre)** vende të lira pune për personel akademik në Departamentin e Kontabilitetit në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës.

Kandidatët konkurentë për personel akademik **në Departamentin e Kontabilitetit**, duhet të plotësojnë këto **kritere të përgjithshme**:

1. Të ketë diplomë Master Shkencor ose diploma ekuivalente me to në fushën e kontabilitetit ose të financës, në Fakultetin e Ekonomisë të UT-së ose në fakultete të tjera publike brenda ose jashtë vendit, të njohura nga MASR.
2. Të ketë përfunduar ciklin e parë dhe ciklin e dytë të studimeve ose DIND me rezultate të larta në secilin prej cikleve të studimit (por jo më pak se nota mesatare 8.5 në ciklin e parë të studimeve Bachelor, dhe jo më pak se nota mesatare 9 në ciklin e dytë të studimeve Master Shkencor dhe në rastin e diplomave DIND jo më pak se nota mesatare 8.5).
3. Të zotërojnë me dëshmi një gjuhë tjetër të huaj perëndimore.
4. Të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.
5. Të ketë një eksperiencë në punë prej jo më pak se 2 vitesh në fushën e kontabilitetit dhe të financës.
6. Të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, nga Universiteti i Tiranës.
7. Të ketë dy rekomandime, nga të cilat të paktën një prej një profesor ose profesor i asociuar nga fakulteti ku është diplomuar dhe një rekomandim nga punëdhënësi i fundit.

Kandidatët konkurentë për këtë vend pune, preferohet të plotësojnë edhe këto **kritere të veçanta**:

1. Të ketë njohuri shumë të miranë fushën e kompjuterizimit të kontabilitetit.
2. Të kenë përvojë në mësimdhënie në lëndët e kontabilitetit në Fakultetin e Ekonomisë të UT-së
3. Të ketë kualifikime pasuniversitare (përfshirë grada dhe tituj shkencore), publikime në revista shkencore, konferenca ose pjesëmarrje në kërkim shkencor në fushën e specialitetit.
4. Të jetë komunikues, i motivuar dhe i dedikuar.
5. Preferohet të njohë gjuhën angleze.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Kandidatët konkurrentë duhet të paraqesin këtë dokumentacion:

1. Kërkesë me shkrim
2. Curriculum vitae
3. Diplomë e studimeve universitare (*fotokopje e noterizuar*).Për diplomat e marra në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet fotokopje e noterizuar e çertifikatës së njohjes nga organi kompetent.
4. Listë notash (*fotokopje e noterizuar*)
5. Dëshmi të gradës ose titujve shkencorë (*fotokopje e noterizuar*)
Për diplomat master të marra në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet fotokopje e noterizuar e çertifikatës së njohjes nga organi kompetent ose vërtetim që janë në proces njohje.
6. Dëshmi të pjesëmarrjes në konferenca apo seminare, Workshop etj
7. Të ketë dy rekomandime, nga të cilat të paktën një prej një profesor ose profesor i asociuar nga fakulteti ku është diplomuar dhe një rekomandim nga punëdhënësi i fundit.
8. Dëshmi penaliteti
9. Dëshmi e zotërimit të gjuhës së huaj (*fotokopje e noterizuar*).
- 10.Kopje të botimeve të artikujve, teksteve, revista, projekte shkencore etj.

Dokumentat dorëzohen pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Rektoratin e Universitetit të Tiranës.

Përzgjedhja e kandidatëve fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervista të drejtpërdrejta.

Afati i dorëzimit të dokumentacionit është **nga data 26.03.2018-09.04.2018.**

Për çdo sqarim mund të kontaktoni në numrin e telefonit 225 84 49.

REKTORI

PROF.DR.MYNYR KONI